



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA HIMARË**  
**DREJTORIA JURIDIKE**

14.15

Nr. 2078 prot.

Himarë, më 19.03 . 2026

**Lënda:** Dërgohet për miratim projektvendimi “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të bashkisë Himarë”.

**KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË**

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, nenit 28, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, vendimit nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 103, datë 11.02.2026, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026, vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr.127 vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 26.2.2026, vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 131, datë 27.02.2026, .”, si dhe në relacionin e paraqitur nga grupi i punës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë;


Bashkëlidhur ju dërgojmë:

- Projektvendimin “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të bashkisë Himarë”.

- Relacion: Mbi projektvendimin “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të bashkisë Himarë”

**KRYETARI**  
Vangjel Tavo

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR**  
**ZËVENDËSKRYETARI**  
Erifili Berberi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE

Nr. 2078/prot.

Himarë, më 19.03.2026

### PROJEKTVENDIM

Nr. 15, Datë, 19.03.2026

### “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË”

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, nenit 28, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, vendimit nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 103, datë 11.02.2026, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026, vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr.127 vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 26.2.2026, vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 131, datë 27.02.2026, ,” si dhe në relacionin e paraqitur nga grupi i punës, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë Himarë;

### VENDOSI:

1. Miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të Bashkisë Himarë, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3, nr. 4, nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8, nr. 9, e nr. 10 bashkëngjitur këtij vendimi.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, fillojnë nga data 1 Janar 2026 dhe për vitin 2026 përballohen.
  - a) për nivelet e pagave, sipas kufirit minimal, nga fondi i kontingjencës për rritjen e pagave, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”;
  - b) për çdo nivel page, të miratuar mbi kufirin minimal e deri në kufirin maksimal, nga buxheti i Bashkisë Himarë për 2026.
3. Ndryshimet e këtij vendimi të pasqyrohen në vendimin nr. 64 datë 22.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë për vitin 2026”, dhe PBA përkatëse.
4. Vendimi nr.28, datë 29.08.2024, i Këshillit Bashkiak Himarë “Për miratimin e niveleve të pagave të punonjësve të bashkisë Himarë”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen drejtoria e burimeve njerëzore, informacionit dhe shërbimeve digjitale, drejtoria e financës, planifikimit të buxhetit dhe menaxhimit të aseteve, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i përditësuar.

**KRYETARI I BASHKISË**

Vangjel Tavo



**Lidhja nr. 1 – Niveli i pagave për funksionarët e zgjedhur, e emëruar, funksionarët e kabineteve dhe për pozicionet sekretar.**

a) Për Kryetar dhe nënkryetar deri në 50.000 banorë.

Emërtimi	Paga për pozicion
Kryetar	246.000
Zwvendskryetar	189.625

b) Për funksionarët e kabinetit dhe pozicionet sekretar.

Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
II-2	Drejtor i kabinetit të Kryetarit	1	144.525
II-2	Sekretar i Këshillit Bashkiak	1 ose 2 ose 3	144.525
III-2	Këshilltar i Kryetarit	1 ose 2 ose 3	109.000
IV-4	Sekretar i Kryetarit	1 ose 2 ose 3	65.000

**Funksionarët e kabinetit dhe pozicionet sekretar përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:**

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

**Lidhja nr. 2 – Niveli i pagave për nëpunësit civil dhe nëpunësit e administratës të punësuar me kod pune.**

Kategoria	Klasa	Emërtesat e pozicioneve të punës për çdo kategori	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
I	I-5	Sekretar i Përgjithshëm	1	174.250
II	II-2	Drejtor drejtorie	1	144.525
III	III-2	Përgjegjës sektori Kryeinspektor	1	109.000
	III-3	Përgjegjës sektori	1	102.000
IV	IV-3	Specialist/ Inspektor	1 ose 2 ose 3	75.000
	IV-4	Specialist	1 ose 2 ose 3	65.000

**Nëpunësit civil, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:**

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të viteve të sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak të detyrueshëm, viteve të shkollimit në institucionet e arsimit të lartë, si dhe periudhës së trajtimit me pagesë papunësie.

**Lidhja nr. 3 – Niveli i pagave për punonjësit e IMT-së dhe sektorit të emergjencave civile.**

<b>Klasa</b>	<b>Emërtesat e pozicioneve të punës</b>	<b>Grupi i diplomës</b>	<b>Paga për pozicion</b>
III-2	Kryeinspektor i IMT-së	1	109.000
IV-3	Inspektor i IMT-së	1 ose 2 ose 3	75.000
III-2	Përgjegjës i sektorit të emergjencave civile	1	109.000
IV-3	Specialist i emergjencave civile	1 ose 2 ose 3	75.000

**Punonjësit e IMT-së dhe sektorit të emergjencave civile, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:**

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

**Lidhja nr. 4 – Niveli i pagave për punonjësit administrativë.**

<b>Emërtesat e pozicioneve të punës</b>	<b>Paga bazë</b>	<b>Vjetërsia</b>
Punonjës administrativë	57.000	1%

Punonjësit administrativë, përveç pagës bazë, përfitojnë shtesën për vjetërsi në punë. Kjo shtesë aplikohet në masën 1 për qind mbi pagën bazë të përcaktuar për çdo klasë. Për llogaritjen e kësaj shtese merret për bazë vjetërsia e përgjithshme në punë, por jo më shumë se 25 vjet.

**Lidhja nr. 5 – Niveli i pagave për punonjësit e policisë bashkiake.**

<b>Emërtesat e pozicioneve të punës</b>	<b>Paga për pozicion</b>
Drejtues i policisë bashkiake	120.000
Inspektor i policisë bashkiake	100.000
Punonjës i policisë bashkiake	80.000

**Punonjësit e policisë bashkiake, përfitojnë edhe shtesën për vjetërsi në punë, e cila jepet në masën:**

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

**Lidhja nr. 6 – Niveli i pagave për punonjësit mbështetës në Bashkinë Himarë.**

Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa	Vjetërsia	Paga bazë	Shtesa për natyrë të veçantë pune
Manovrator	XIII	1%	56.700	4.000
Roje mjedisore/pyjesh me arsim të lartë	VIII	1%	54.100	4.000
Roje mjedisore/pyjesh me arsim të mesëm	VII	1%	53.600	4.000
Kujdestare çerdhe	VII	1%	53.600	4.000
Teknikë të mesëm të specialiteteve të ndryshme	V	1%	52.800	4.000
Elektracist	V	1%	52.800	4.000
Magazinionier	IV	1%	52.500	4.000
Shofer	III	1%	51.800	4.000
Punonjës mirëmbajtës të profesioneve të ndryshme	III	1%	51.800	4.000
Punëtor mirëmbajtje	III	1%	51.800	4.000
Punëtor pastrimi/Sanitar	I	1%	50.000	4.000
Roje objektësh	I	1%	50.000	4.000

**Shënim:** Shtesa për natyrë të veçantë pune është caktuar në zbatim të gërmës *m*, të pikës 1, të VKM-së nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.5.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, të ndryshuar me VKM nr. 87 datë 6.2.2026.

Shtesa për vjetërsi në punë llogaritet për çdo vit pune, në masën 1 (një) për qind të pagës bazë për klasë, por jo më shumë se 25 (njëzet e pesë) vjet. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, “vite pune” do të konsiderohet vjetërsia e përgjithshme në punë, e dokumentuar në librezën e punës së çdo punonjësi, apo, në mungesë të librezës së punës, me çdo dokument tjetër ligjor, të lëshuar nga organet kompetente përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi. Përfshihen nga kjo llogaritje vitet e sigurimit vullnetar, vetëpunësimit, shërbimit ushtarak për meshkujt, vitet e shkollimit në institucionet e arsimit të lartë dhe periudha e trajtimit me pagesë papunësie.

**Lidhja nr. 7 – Niveli i pagave për punonjësit mësimorë të institucioneve të arsimit parashkollor.**

Bazuar në vendimin nr. 425, datë 26.06.2026, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar, në arsimin parauniversitar” i ndryshuar me VKM nr. 127, datë 27.2.2026.

Emërtimi i pozicionit të punës	Grupi i diplomës	Paga e pozicionit	Shtesa për kategorinë e kualifikimit
Edukator në kopësht fëmijësh	1 ose 2 ose 3 ose 4	61.000	10 % e G.D - Mësues i kualifikuar 20 % e G.D - Mësues specialist 30 % e G.D - Mësues mjeshtër

**Shtesa për vjetërsi në punë për punonjësit mësimorë, jepet në masën:**

- i. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- ii. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- iii. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

### Lidhja nr. 8 – Niveli i pagave për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri.

Bazuar në vendimin nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 11.2.2026.

Niveli	Grada	Paga bazë për gradë	Shtesa për natyrë të veçantë pune	Vjetërsia
Niveli bazë	Asistent zjarrfikës	65.000	7.000	1%
	Zjarrfikës	69.000	8.000	1%
	Kryezjarrfikës	70.000	8.000	1%
Niveli i mesëm	Nënkomisar zjarrfikës	75.000	6.000	1%
	Komisar zjarrfikës	88.000	6.000	1%
	Kryekomisar zjarrfikës	108.000	6.000	1%

Punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin, për çdo vit vjetërsi shërbimi, përfitojnë shtesë mbi pagë, në masën 1(një) % për çdo vit, deri në 25 (njëzet e pesë) vjet. Kjo shtesë llogaritet mbi vlerën e pagës bazë të gradës “**Asistent zjarrfikës**”. Për efekt të llogaritjes së kësaj shtese, vite shërbimi do të konsiderohen vitet e qëndrimit në gradë, të dokumentuara në librezën e punës së çdo punonjësi, në strukturat e Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, Forcave të Armatosura së Republikës së Shqipërisë, Policisë së Burgjeve, Gardës së Republikës, Agjencisë së Mbikëqyrjes Policore, Policisë së Shtetit si dhe në strukturat e Shërbimit Informativ të Shtetit.

### Lidhja nr. 9 – Niveli i pagave për nëpunësit e gjendjes civile.

Bazuar në lidhjen nr. 1, të vendimit nr. 131, datë 27.02.2026 të Këshillit të Ministrave “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Emërtesat e pozicioneve të punës	Klasa e pagës	Grupi i diplomës	Paga për pozicion
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në bashki	III-3	1	102.000
Përgjegjës i zyrës së gjendjes civile në njësi administrative	IV-1	1	90.000
Specialist i zyrës së gjendjes civile në bashki	IV-3	1 ose 2 ose 3	75.000
Specialist i zyrës së gjendjes civile në njësi administrative	IV-4	1 ose 2 ose 3	65.000

#### Shtesa për vjetërsi në punë për nëpunësit e gjendjes civile, jepet në masën:

1. 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
2. 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
3. 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

**Lidhja nr. 10 – Niveli i pagave për administratorët e njësive administrative.**

<b>Emërtesat e pozicioneve të punës</b>	<b>Paga bazë</b>
Administrator i NJ.A. Himarë	148.625
Administrator i NJ.A. Lukovë	148.625
Administrator i NJ.A. Horë – Vranisht	143.500

**- Niveli i shpërblimit për këshilltarët e Këshillit Bashkiak dhe kryetarët e fshatrave.**

1 – Anëtarët e Këshillit Bashkiak 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë: **24.600 lekë** në muaj.

2 – Kryetarët e fshatrave 10% të pagës mujore të Kryetarit të Bashkisë: **24.600 lekë** në muaj.

**KRYETARI**

Vangjel Tavo





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA HIMARË**

**DREJTORIA E BURIMEVE NJERËZORE, INFORMACIONIT DHE SHËRBIMEVE DIGJITALE**

Nr. 2078/2 prot.

Himarë, më 19.03 .2026

**RELACION:**

**MBI PROJEKTVENDIMIN “PËR MIRATIMIN E NIVELEVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË BASHKISË HIMARË”**

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të nenit 54 të ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, nenit 9, të ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, nenit 28, të ligjit nr. 89/2022 “Për policinë bashkiake”, vendimit nr.328, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar me VKM nr. 103, datë 11.02.2026, vendimit nr. 326, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026, vendimit nr. 425, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar me VKM nr.127 vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 26.2.2026, vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr. 131, datë 27.02.2026, .”

Ky propozim mbështetet në analizën e nevojave reale të strukturës vendore, detyrimeve ligjore, si edhe ngarkesës së shtuar të punës që vjen jo vetëm nga zgjerimi i funksioneve bashkiake, por edhe nga specifikat territoriale dhe sezonaliteti i lartë turistik, si dhe në zbatim të akteve nënligjore përkatëse të Këshillit të Ministrave, të ndryshuara gjatë muajit Shkurt 2026.

## **I. Qëllimi i relacionit**

Qëllimi i këtij relacioni është përshtatja e strukturës dhe niveleve të pagave për punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me ndryshimet e fundit ligjore dhe nënligjore të muajit Shkurt 2026, me synim:

- garantimin e zbatimit korrekt të legjislacionit në fuqi;
- përmirësimin e trajtimit financiar të punonjësve;
- rritjen e motivimit dhe eficiencës në administratë.

## **II. Baza ligjore**

Ky propozim mbështetet në aktet e mëposhtme të ndryshuara:

- Vendimi nr. 328, datë 31.05.2023 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar me VKM nr. 103, datë 11.02.2026;
- Vendimi nr. 326, datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026;
- Vendimi nr. 325, datë 31.05.2023, i ndryshuar me VKM nr. 131, datë 27.02.2026;
- Vendimi nr. 419, datë 26.06.2024, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 26.02.2026;
- Vendimi nr. 425, datë 26.06.2024 (për arsimin parauniversitar), sipas ndryshimeve përkatëse.

Këto ndryshime përcaktojnë rritjen e kufijve të pagave, rishikimin e strukturës së pagave dhe elementëve përbërës të saj për kategori të ndryshme punonjësish dhe indeksimin e pagave sipas ndryshime ligjore të muajit Shkurt 2026.

## **III. Përmbajtja e ndryshimeve**

Në zbatim të akteve të sipërcituara:

- Janë rishikuar nivelet e pagave për funksionarët e zgjedhur dhe të emëruar;
- Janë rritur pagat për nëpunësit civilë dhe punonjësit administrativë;
- Janë përditësuar pagat për punonjësit mbështetës dhe specialistët;
- Janë rishikuar trajtimet financiare për:
  - Policinë Bashkiake;
  - Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin;
  - Punonjësit e arsimit parauniversitar (sipas strukturave përkatëse).

Ndryshimet konsistojnë kryesisht në rritje të pagës bazë dhe/ose elementëve të saj përbërës, në përputhje me klasifikimin dhe grupimin e njësive vendore.

Në zbatim të kuadrit ligjor dhe nënligjor të përditësuar gjatë muajit shkurt 2026, njësia e vetëqeverisjes vendore ka parashikuar përcaktimin e pagave në nivelin maksimal të lejuar për çdo pozicion pune.

Ky qëndrim mbështetet në disa elemente thelbësore:

- Konkurrenca me sektorin privat, i cili në vitet e fundit ka ofruar nivele më të larta pagash për profile të ngjashme profesionale, duke e bërë më të vështirë tërheqjen dhe mbajtjen e burimeve njerëzore në administratën publike;
- Nevoja për rritjen e atraktivitetit të administratës vendore për të rinjtë e kualifikuar, të cilët shpesh zgjedhin sektorin privat ose emigrimin për arsye ekonomike;
- Sigurimi i vazhdimësisë dhe cilësisë së shërbimeve publike, që lidhet drejtpërdrejt me kapacitetin profesional të stafit.

Në këtë kontekst, evidentohet se Bashkia Himarë vijon të ketë vende vakante në strukturën e saj organizative, çka ndikon në:

- rritjen e ngarkesës së punës për stafin ekzistues;
- uljen e eficiencës në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve;
- vështirësi në zbatimin në kohë të funksioneve dhe projekteve të planifikuara.

Për rrjedhojë, paga përbën një nga instrumentet kryesore për tërheqjen e burimeve njerëzore cilësore, si dhe për stabilizimin e stafit aktual. Përcaktimi i saj në nivelin maksimal të lejuar:

- rrit konkurrueshmërinë e administratës vendore në tregun e punës;
- ndihmon në plotësimin e vendeve vakante;
- përmirëson performancën institucionale në tërësi.

Në këtë projektvendim janë pasqyruar gjithashtu elementët përbërës të pagës, përfshirë vjetërsinë në punë dhe shtesat specifike, e cila llogaritet si më poshtë:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite), mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite), mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite), mbi pagën e pozicionit.

Shtesa për natyrë të veçantë pune, ku punonjësit mbështetës përfitojnë një shtesë mujore në masën 4,000 (katër mijë) lekë, në zbatim të VKM-së nr. 422, datë 26.06.2024, të ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026, e cila parashikon indeksimin e pagave për këtë kategori.

Këto elemente kontribuojnë drejtpërdrejt në krijimin e një sistemi pagash më të drejtë dhe motivues dhe në rritjen në tërësi të performancës së punonjësve.

#### **IV. Efektet financiare**

Zbatimi i këtyre ndryshimeve sjell rritje të fondit të pagave për vitin buxhetor 2026. Efekti financiar:

- do të përlllogaritet sipas numrit të punonjësve dhe kategorive përkatëse;
- do të përballohet nga buxheti i miratuar i njësisë vendore dhe/ose fondet e transferuara nga buxheti i shtetit;
- kërkon rishikim të planifikimit buxhetor nëse është e nevojshme.

## V. Përfundime

Për sa më sipër, propozohet:

1. Miratimi i strukturës së re të pagave për punonjësit e njësisë së vetëqeverisjes vendore;
2. Zbatimi i niveleve të reja të pagave sipas akteve të ndryshuara të Këshillit të Ministrave;
3. Fillimi i efekteve financiare nga data e përcaktuar në aktet përkatëse;

Këshilli i Ministrave ka miratuar vendime të reja për nivelet e pagave për punonjësit e njësive të vetëqeverisjes vendore, për punonjësit mbështetës, për punonjësit e MZSH-së dhe për punonjësit e arsimit parashkollor, për punonjësit e gjëndjes civile të cilët janë pjesë e strukturës së bashkive.

Në këtë projektvendim kemi pasqyruar edhe llogaritjen e vjetërsisë së punës, i cili sipas të bëhet sipas formulës së mëposhtme:

- 0.6% pas çdo viti pune për 10 vitet e para (1–10 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 0.8% pas çdo viti pune për 10 vitet e dyta (11–20 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;
- 1% pas çdo viti pune për 10 vitet e treta (21–30 vite) dhe llogaritet mbi pagën e pozicionit;

Punonjësit mbështetës marrin një shtesë për natyrë të veçantë pune në shumën 4000 (katër mijë) lekë, në zbatim të gërmës m, të pikës 1, të VKM-së nr. 422, datë 26.06.2024 “Për një ndryshim në vendimin nr. 326, datë 31.05.2023, të Këshillit të Ministrave, “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike”, e ndryshuar me VKM nr. 87, datë 06.02.2026 i cili bën indeksimin e pagave.

Në zbatim të vendimit nr. 425, datë 26.06.2024, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të punonjësve mësimorë dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë në institucionet arsimore dhe në institucionet plotësuese të sistemit arsimor parauniversitar“ ndryshuar me VKM nr.127 datë 27.2.2026”, vendimit nr. 419, datë 26.06.2024 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerave për secilin element përbërës të pagës bruto mujore të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, i ndryshuar me VKM nr. 104, datë 26.6.2024 vendimit nr. 325, datë 31.05.2023 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës së pagave, niveleve të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrit, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civilë dhe nëpunësve në disa institucione të administratës publike”, i ndryshuar me VKM nr131, datë 27.02.2026, janë pasqyruar ndryshimet përkatëse sipas vendimeve të mësipërme në pagat e punonjësve të MZSH-së, punonjësve të gjëndjes civile dhe punonjësve të arsimit parashkollor.

Të gjitha ndryshimet që përmendëm më sipër janë pasqyruar në lidhjet nr. 1,2,3,4,5,6,7,8, 9 e 10 të projektvendimit që ju kemi paraqitur për miratim.

Për sa ju parashtruar në këtë relacion, bazuar në kërkesat e pikës “ç”, të nenit 54, të ligjit nr. 139/2015, “Për vetqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe nenit 9, të ligjit nr. 35/2023 “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, kërkojmë miratimin e këtij projektvendimi nga Këshilli i Bashkisë Himarë, duke theksuar gjithashtu gatishmërinë për të reflektuar çdo propozim për ndryshim apo plotësim të këtij projekt vendimi nga ju, të nderuar këshilltarë.

Drejtore i DFPBMA

Besa Xhaferi



Drejtore i DBNJISHD

Ergis Papaproko



DREJTOR JURIDIK

Ardit Muhametaj

